



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2019

Prishtinë, Mars, 2020

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje.....	4
Metodologjia	5
Përmbledhje ekzekutive	6
FUNKSIONIMI I KOMUNAVE	8
Kuvendi i Komunës.....	8
Komitetet e Kuvendit të Komunës	9
Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative	10
Aktet e kuvendeve të komunave.....	11
Transparenca dhe llogaridhënia komunale	12
Siguria në Bashkësi.....	15
Mbikëqyrja e komunave	16
AGJENDA EVROPIANE	18
Kriteret politike	19
Kriteret ekonomike	22
Standardet Evropiane	23
FINANCAT LOKALE.....	26
Planifikimi i të hyrave vetanake.....	27
Realizimi i të hyrave vetanake	27
Buxheti Komunal për vitin 2019	29
Shpenzimet krahasuar me buxhetimin	29
Opinion i auditorit për komunitat e Republikës së Kosovës	30
Rekomandimet.....	31

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KK	Kuvendi Komunal
KKSB	Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshilli Lokal për Siguri Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MF	Departamenti i Thesarit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
ML	Ministritë e Linjës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ

Hyrje

Gjatë vitit 2019 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përkushtuar në zbatimin e prioriteteve të saja strategjike në funksion të mbështetjes dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në vitin 2016, ka hyrë në fuqi Strategjia dhjetëvjeçare për Vetëqeverisje Lokale (2016 – 2026), e cila ofron një vizion të qartë për ecurinë e reformës dhe zhvillimit të pushtetit lokal. Në përputhje me objektivat zhvillimore të saj, janë operacionalizuar aktivitetet dhe janë përcaktuar një mori e masave të kërkuara veçanërisht nga pushteti lokal. Shtyllë kryesore e synuar mbetet qeverisja e mirë në nivel lokal, transparenca komunale, mbikëqyrja dhe kontrolli i ligjshmërisë, efikasiteti i shërbimeve dhe prioritizimi i obligimeve të komunave nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Raporti për funksionimin e komunave është dokument që vlerëson progresin e komunave gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019. Ky raport hartohet çdo vit me datë 31 Mars dhe i njëjti paraqitet para Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij raporti është të informohen drejtë: Qeveria qendrore, Kuvendi i Republikës së Kosovës, komunat, shoqëria civile, qytetarët dhe cilido grupi tjetër i interesit lidhur me funksionimin dhe shkallën e arritshmërisë së progresit të komunave, por edhe sfidave të mbetura. Raporti ofron konkluzionet lidhur me fushat përkatëse dhe jep rekomandimet specifike për komunat që duhet adresuar në të ardhmen.

Raporti ka këtë strukturë, si vijon:

- Përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon fushën e transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore.
- Jep një pasqyrë të opinioneve të auditorit të përgjithshëm për komunat.

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Metodologjia

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara në procesin e monitorimit të komunave nga Departamentet dhe njësitë përgjegjëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë përdorur burime të ndryshme të të dhënave, të siguruara nga zyrtarët komunal, si dhe informata të tjera të siguruara nga monitoruesit në terren. Një pjesë e të dhënave janë marrë nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave, si dhe nga raportet për obligimet e komunave që dalin nga agjenda evropiane. Gjithashtu, të dhënat janë siguruar edhe përmes pyetësorëve të dizajnuar për mbledhjen e të dhënave në fushat përkatëse të paraqitura në raport. Raporti ka një metodologji përshkuese (*deskriptive*) dhe analitike të punës së funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2019, komunat kanë shënuar një progres të konsiderueshëm në strukturat e tyre vendimmarrëse për të vazhduar me aktivitetet e planifikuara sipas prioriteteve të tyre strategjike. Është parë progres i shtuar i kuvendeve të komunave në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke aprovuar një numër të konsiderueshëm të akteve në pajtim me legjislacionin në fuqi. Për një vit pune, kuvendet e komunave mbajtën 500 mbledhje, prej të cilave 413 kanë qenë të rregullta, 48 të jashtëzakonshme, 34 solemne, 5 urgjente. Të gjitha komunat kanë përmbushur numrin minimal prej 10 mbledhjeve të kërkuara sipas nenit 43.2 të LVL-së. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë të hapura për publikun, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të informohen rregullisht për zhvillimet e politikave lokale. Paralelisht me kuvendet, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar edhe komitetet obligative, si dhe komitetet e tjera të themeluara. Sipas të dhënave, janë mbajtur 422 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 369 të Komitetit për Komunitete. Krahas kësaj, 15 komuna kanë themeluar 62 komitete ndihmëse për sektorë të ndryshëm, si dhe 43 komitete konsultative të themeluara në 16 komuna.

Për nga numri i akteve të kuvendeve, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 2038 akte, prej të cilave janë 148 rregullore dhe 1890 vendime. Numri më i madh i rregulloreve është aprovuar në Lipjan, Shtime, Istog dhe Graçanicë, derisa vendime më së shumti kanë aprovuar kuvendet e komunave: Malishevë, Mitrovicë Jugore dhe Obiliq. Kuvendet e komunave kanë ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit të komunës. Sipas të dhënave, 29 kryetarë të komunave kanë përmbushur kriterin minimal prej 2 raportimeve brenda vitit para kuvendit. Llogaridhënia e kryetarëve duhet të shtohet në 9 komuna, ashtu që raportimet e tyre të paraqiten në kuvende sipas afateve ligjore të përcaktuara me LVL (Novobërdë, Skenderaj, Kllokot, Partesh, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Prishtinë).

Promovimi i transparencës komunale mbetet një nga çështjet kyçe të qeverisjes demokratike. Në këtë drejtim, janë mbajtur 67 takime publike me qytetarë në 37 komuna. Kushti me së paku 2 takime gjithëpërfshirëse me qytetarë nuk është përmbushur në 7 komunat: Podujevë, Kamenicë, Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore (me vetëm 1 takim), si dhe 1 komunë Fushë Kosovë e cila nuk ka mbajtur asnjë takim. Sa u përket akteve të aprovuara në 33 komuna rreth 99.8% të tyre janë publikuar në ueb-faqet e komunave pas aprovimit kurse niveli i publikimit të akteve në komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Leposaviq, Shtërpcë dhe Zveçan ka qenë 0%. Lidhur me qasjen në dokumentet publike, komunave u janë parashtruar 1101 kërkesa nga qytetarët. Prej tyre, komunat kanë lejuar qasje në 1062 kërkesa (apo 96%), 28 janë refuzuar (3%), si dhe 11 janë aprovuar pjesërisht (1.86%).

Gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore në komuna. Edhe pse jo në masën e duhur, punësimi i grave në nivel lokal është prezent në kuadër të pozitive menaxheriale. Sipas të dhënave të 35 komunave, në pozita menaxheriale janë të sistemuara 1604 gra. Krahas tyre, në administratën dhe kuvendet e 37 komunave, të dhënat tregojnë për 3550 gra të punësuar nga të gjitha komunitetet. Megjithatë, ka nevojë të ngritet vetëdija e përgjithshme institucionale dhe shoqërore, ashtu që të adresohet edhe një nga rekomandimet kryesore të BE-se për përfshirje të grave në pozita vendimmarrëse. Në raportin e fundit të KE-së për Kosovën, është vënë theksi që nga 204 kandidatë

për kryetarë komunash vetëm 8 kanë qenë gra. Gjithashtu, në 38 komuna janë emëruar vetëm 2 gra nënkryetare. Krahas kësaj, janë zgjedhur vetëm 6 gra kryesuese të kuvendeve të komunave, ndërkohë nga 364 drejtorë të drejtorive komunale, vetëm 75 pozita të tilla udhëhiqen nga gratë apo 20.60%.

Siguria në bashkësi mbetet përgjegjësi e përbashkët institucionale me qëllim të uljes së rreziqeve ndaj jetës dhe sigurisë së qytetarëve. Kufijtë e mbrojtjes policore nuk mjaftojnë për t'u përballur me çrregullimet e shumta që mund të ndodhin në bashkësi, për çfarë kërkohet bashkëpunim dhe bashkërendim i të gjitha mekanizmave, përfshirë: komunave, policisë, akterëve të shoqërisë civile, qytetarëve, mediave etj. Për këtë arsye, këshillat për siguri në bashkësi janë forume të cilat mund të sjellin ndryshime esenciale në politikat e sigurisë në bashkësi dhe në përcaktimin e prioritetëve në këtë fushë. Kryetarët e komunave janë kujdesur që gjatë vitit 2019 të mbahen 186 takime të KKSBB-ve. Funksionimi normal i këtyre trupave është arritur në 34 komuna, derisa 4 komuna: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan, dhe Zubin Potok nuk janë themeluar, në përgjithësi gjatë vitit 2019 ka pasur ngritje të aktiviteteve të KKSBB-ve, krahasuar me vitet paraprake. Gjatë vitit 2019, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 2038 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave. MAPL ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së 976 akteve apo 47.8%, ndërsa 1062 akte janë shqyrtuar nga ministrinë e linjës (52.1%). Janë konstatuar 157 shkelje, prej të cilave 56 janë konstatuar nga MAPL dhe 101 nga Ministrinë e linjës. Komunitat kanë arritur të harmonizojnë gjithsej 106 akte, derisa 51 akte mbeten të pa harmonizuara me ligj apo 2.5% nga totali i akteve të aprovuara. Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka iniciuar procedurat e kundërshtimit gjyqësor përmes Ministrisë së Drejtësisë për 29 akte të kuvendeve të komunave si vijon: Vushtrri (1), Gjakovë (4), Lipjan (3), Skenderaj (3), Deçan (3), Prishtinë (9), Malishevë (2), Graçanicë (1), Prizren (1), Gjilan (1) dhe Mitrovicë Jugore (1). Komunitat të cilat nuk kanë harmonizuar aktet edhe pas dërgimit të kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti mbikëqyrës janë: Prizren (2), Malisheve (1), Ferizaj (1), Gjilan (1), Dragash (1), Deçan (2), Shtime (1), Istog (1), Mitrovicë Jugore (1), Junik (1), Kamenicë (1), Vitisë (1), Kllokot (1), Graçanicë (1), Ranillug (1), Shtërpçë (1), Gllogoc (2), Gjakovë (1) dhe Fushë Kosovë (1).

Kosova është duke kaluar nëpër një stad të rëndësishëm të zhvillimeve dhe ndërtimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Marrëveshja për Stabilizim Asociim e nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe BE ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016, derisa Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i cili përbën dokumentin kryesor nacional të politikave për aderim në BE. Komunitat si aktor të rëndësishëm shtetëror kanë barrën e tyre të përgjegjësisë në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kriterëve kryesorë të integritit: a) Politike, b) Ekonomike, c) Standardeve Evropiane. Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunitat, gjatë vitit 2019 komunitat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 71% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike, komunitat kanë arritur që t'i përmbushin 71% të kriterëve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 66% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2019 është 69%.


FUNKSIONIMI I KOMUNAVE

Kjo pjesë përmbledhë mënyrën e funksionimit të organeve të komunave të Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë kompetencat e nivelit lokal të qeverisjes. Po ashtu, kjo pjesë fokusohet në monitorimin e elementeve kryesore të funksionimit të kuvendeve komunale, përmbajtja e të cilave garanton qëndrueshmërinë e organeve komunale, respektimin e procedurave ligjore, respektimin e ligjshmërisë, efikasitetin, transparencën, bashkëpunimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin.

Kuvendi i Komunës

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i pushtetit lokal dhe njëkohësisht është organ i autorizuar ligjërisht për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e tij, kuvendi i komunës duhet të mbledhet rregullisht për të miratuar aktet e nevojshme normative të komunës të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi dhe atyre që duhet nxjerrë, varësisht nga nevojat e komunës, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të përgjithshëm.

Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar standardet minimale që i referohen mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës për të siguruar konsistencë të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmuorin e parë të vitit¹. Duke ju referuar të dhënave nga MAPL, gjatë vitit 2019 kuvendet e komunave kanë mbajtur 500 mbledhje, prej tyre 413 kanë qenë të rregullta, 48 të jashtëzakonshme, 34 solemne dhe 5 urgjente të cilat i kemi paraqitur, si vijon:



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave në periudhën Janar - Dhjetor 2019.


¹ Ligji Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Sipas të dhënave, vërehet se të gjitha komunat kanë përmbushur minimumin e kërkuar për mbajtje të mbledhjeve sipas nenit 43.2 të LVL-së. Në të gjitha rastet, mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun, duke dhënë mundësinë e informimit të rregullt të qytetarëve për zhvillimet e politikave në nivelin lokal të qeverisjes. Edhe pse dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për arsye specifike lejojnë që komunat të përjashtojnë publikun nga mbledhjet e kuvendit, deri tani nuk është marrë ndonjë vendim nga kuvendet e komunave për përjashtim të publikut. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe formave të tjera të informimit publik. Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se komunat në përgjithësi e kanë njoftuar organin mbikëqyrës së bashku me ftesën për mbledhje kanë dërguar edhe materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Monitorimi i punës së kuvendeve është bërë përmes sistemit të tele-prezencës, kurse me pjesëmarrje fizike në komunat: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore.

Në përgjithësi mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave ka qenë konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, megjithëse janë evidentuar disa raste të dështimit të mbledhjeve për arsye të: dërgimit të materialit me vonesë (Kaçanik), bojkotit të anëtarëve të kuvendeve (Mitrovicë e Jugut dhe Shtime), mungesës së kuorumit (Partesh).

Komitetet e Kuvendit të Komunës

Me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme dhe komitetet e tjera për të mbështetur punën e tyre. Këto komitete janë themeluar dhe kanë funksionuar në të gjitha komunat. Marrë parasysh numrin e takimeve, Komiteti Politikë dhe Financa duhet të jetë më aktiv në komunën e Prizrenit. Në anën tjetër, Komiteti për Komunitete ka pasur intensitet shumë të ulët të takimeve në komunën e Kaçanikut. Sipas të dhënave, në periudhën Janar – Dhjetor 2019, gjithsej janë mbajtur 791 takime. Komiteti për Politikë dhe Financa kanë mbajtur 422 takime, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 369 takime, si vijon:



Diagrami 2: Numri i mbledhjeve të Komiteteve të Përhershme në periudhën Janar - Dhjetor 2019.

Duke marrë parasysh se Komiteti për Politikë dhe Financa është organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit, rrjedhimisht puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës. Mbi bazën e kësaj, ky komitet takimet duhet t'i mbajë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, duke marrë parasysh funksionet e përcaktuara edhe me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave.

Komiteti për Komunitete, është komiteti i dytë i përhershëm i kuvendit të komunës, detyrë e të cilit është shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ai gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuatë të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.


Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative

Kuvendi i komunës mund të themeloj komitete të tjera profesionale nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta për sektor specifik si: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Për të rritur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesuara në procesin e vendimmarrjes komunale, kuvendi i komunës themelon edhe komitete konsultative brenda sektorëve përkatës qeverisës. Gjatë vitit 2019, vetëm 16 komuna kanë themeluar 43 Komitete Konsultative, edhe pse Kuvendi i Komunës, bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe UA (MAPL) Nr.02/2018 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, është i obliguar të themeloj edhe komitetet konsultative, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Komitetet konsultative janë themeluar në komunat: Kamenicë (5), Hani i Elezit (3), Skenderaj (4), Prishtinë (1), Mitrovicë Jugore (3), Kaçanik (1), Istog (3), Gjilan (1), Glogoc (5), Vushtrri (6), Klinë (2), Deçan (1), Junik (1), Pejë (4), Rahovec (1) dhe Viti (1). Fushat e mbuluara nga këto komitete janë: Personat me aftësi të kufizuara (7), Zhvillimi Ekonomik (5), Shërbimet Publike (5), Çështjet Emergjente (5), si dhe Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (5).

Sa i përket Komiteteve tjera ndihmëse, në këtë periudhë 15 komuna kanë themeluar gjithsej 62 komitete të tjera. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për Shëndetësi, Arsim dhe në fushën e urbanizmit. Komitete të tjera (ndihmëse) kanë themeluar kuvendet e komunave: Gjakovë (2 komitete), Shtime (2), Fushë Kosovë (8), Gjilan (11), Kaçanik (1), Mitrovicë Jugore (6), Ferizaj (5), Ranillug (1), Klinë (5), Pejë (3), Prishtinë (5), Viti (5), Skenderaj (4), Podujevë (2) dhe Graçanicë (2). Fushat më të mbuluara nga këto komitete janë: Shërbime publike (11), Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (9), Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (9), Planifikim Hapësinor (7), Zhvillim Ekonomik (7).

Aktet e kuvendeve të komunave

Kuvendi Komunës ka në kompetencë miratimin e vendimeve dhe rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat në nivel lokal. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, merr vendime, nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Gjatë periudhës raportuese shumica e kuvendeve të komunave kanë qenë aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Për nga numri, janë miratuar gjithsej 2038 akte komunale, prej të cilave 148 rregullore dhe 1890 vendime.




Diagrami 3: Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave, janar-dhjetor 2019.

Pasqyra e të dhënave për aktet e miratuara tregon se numrin më të madh të Rregulloreve e ka miratuar Kuvendi i Komunës së Lipjanit, Shtimes, Istogut dhe Graçanicës, derisa numrin më të madh të vendimeve e kanë miratuar kuvendet e komunave: Malishevë, Obiliq dhe Mitrovicë Jugore. Komunitat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore, që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret janë: miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike etj. Komunitat me pasive në këtë drejtim kanë qenë komunitet: Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Novobërdë, Mamushë dhe Ranillug.

Procesi i administrimit të kërkesave të komunave për kthimin e pronës së AKP-së - Gjatë kësaj periudhe, komunitat kanë parashtruar një numër të madh të kërkesave ndaj qeverisë qendrore, për të mundur bartjen (kthimin) e pronave të paluajtshme të cilat janë në menaxhim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, si dhe pronave të cilat menaxhohen nga institucionet e nivelit qendror. Numri i kërkesave të pranuar nga komunitat në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2018 ka qenë rreth 40, përderisa në vitin 2019 ky numër është më i vogël, gjithsej 19 kërkesa.

Transparenca dhe llogaridhënia komunale

Raportimi i kryetarit - Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar obligimin e kryetarit të komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në bazë të paragrafit j) të nenit 58 të këtij ligji, kryetari i komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës. Të dhënat flasin se gjatë vitit 2019 numri i raportimeve të kryetarëve të Komunave para kuvendit ka qenë 91, të cilat janë paraqitur, si vijon:




Diagrami 4: Numri i raportimeve të kryetarëve para kuvendeve të komunave.

Diagrami i lartcekur pasqyron të dhënat se në 29 komuna kryetarët e komunave kanë përbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 11 komuna: Istog, Lipjan, Kaçanik, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Pejë, Podujevë, Shtime, Viti, Skenderaj dhe Gjakovë kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 8 komuna, kryetarët nuk e kanë përbushur obligimin ligjor për raportim të paktën 2 herë brenda vitit, siç është e përcaktuar në LVL, komunitat: Novobërdë, Klllokot, Partesh, Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë Veriore, pasi kryetarët e komunave kanë raportuar vetëm nga 1 herë, ndërsa në Komunën e Prishtinës, kryetari i komunës nuk ka raportuar asnjëherë në këtë periudhë.

Forma të tjera të llogaridhënies janë edhe përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dhe me shkrim të parashtruara nga anëtarësia e kuvendit ndaj ekzekutivit. Për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet kuvendit dhe ekzekutivit të komunës, është i nevojshëm shtimi i prezencës së rregullt të kryetarëve dhe drejtorëve në mbledhjet e kuvendeve të tyre. Një komunikim i vazhdueshëm i të dy organeve i kontribuon demokracisë lokale, rritë cilësinë e vendimmarrjes dhe ligjshmërisë, zgjeron rrethin e aktorëve përgjegjës për hartimin e politikave të zbatueshme me interes të përgjithshëm, si dhe ndërton segmente të llogaridhënies brenda administratës komunale.

Takimet publike me qytetarë - Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunitatet janë të obliguara të vënë në funksion standarde të përcaktuara me udhëzimin administrativ Nr. 06/2018 për standardet minimale për konsultim publik në komuna, dhe atë përmes: takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe metoda të tjera me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo komunë mbanë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Njëra nga mbledhjet duhet të mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të ngritin çështje të ndryshme dhe të japin propozime para organeve komunale. Në vitin 2019, organizimi i takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë në komuna ka qenë si në vijim:



Diagrami 5: Numri i takimeve publike me qytetarë në vitin 2019.

Diagrami i mësipërme tregon se në 37 komuna janë mbajtur 67 takime me qytetarë. Prej tyre, 30 komuna kanë organizuar nga 2 takime publike me qytetarë, 7 komuna: Podujevë, Kamenicë, Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore kanë organizuar vetëm 1 takim, derisa komuna e Fushë Kosovës nuk ka mbajtur asnjë takim në këtë periudhë.

Përveç këtyre takimeve, komunitatet kanë mbajtur edhe takime të tjera me qytetarë në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, janë bërë me rastin e diskutimit të projekt-rregulloreve, planeve dhe çështjeve buxhetore, të cilat qytetarëve u kanë mundësuar ofrimin e sugjerimeve, propozimeve dhe kërkesave të tyre. Gjithashtu, sipas të dhënave të 34 ueb-faqeve të komunave, gjatë periudhës raportuese janë publikuar 234 njoftime për debate/dëgjime publike. Komunitatet që kanë mbajtur më së shumti debate publike për buxhetin dhe projekt-rregulloret janë: Gillogoc, Gjilan, Kaçanik, Klllokot, Lipjan, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Suharekë, Rahovec, Shtime, Vushtrri dhe Gjakovë.

Ndërsa, njoftimet për dëgjime publike me qytetarë nuk janë publikuar në ueb-faqet e komunave: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore.

Mbajtja e takimeve publike dhe formave të tjera të konsultimit publik duhet të jetë proces i vazhdueshëm në të gjitha fazat e politikbërjes në komunë. Lidhur me këtë, janë hartuar edhe rregullat për standardet minimale të konsultimit publik për komuna, të cilat kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2019.

Ueb-faqet zyrtare të komunave - Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. Përderisa në vitin 2018 është realizuar projekti për ridizajnimin e ueb-faqeve të të gjitha komunave, në vitin 2019 ndryshimet e tyre kanë sjellë integrimin e sistemit të intranetit në ueb-faqet e komunave, ku qytetarët mund të adresojnë kërkesat për pajisje me dokumentet e gjendjes civile. Gjithashtu, në këtë drejtim është krijuar qasja në gjurmimin e lejeve të ndërtimit, paraqitjes së kërkesave të qytetarëve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimi online i mbledhjeve të kuvendeve të komunave.

Struktura e ueb-faqeve mundëson qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në të gjitha dokumentet relevante të destinuara për publikim. Përditësimi i të dhënave të komunave është bërë në vazhdimësi, edhe pse ka vend për përmirësim sidomos në publikimin e akteve normative në gjuhët zyrtare. Sipas të dhënave, gjatë kësaj periudhe nga 38 ueb faqe të komunave, në 29 prej tyre janë publikuar gjithsej 270 procesverbale të mbledhjeve të kuvendeve të komunave nga gjithsej 500 mbledhje të mbajtura. Shkalla e publikimit të tyre është 54%. Kurse, 9 komuna të tjera: Leposaviq, Obiliq, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Ranillug, Junik dhe Partesh nuk kanë publikuar asnjë nga procesverbalet nga mbledhjet e kuvendeve të komunave në këtë periudhë.

Nga totali i 1890 vendimeve të aprovuara në kuvendet e komunave, komunat kanë publikuar 1887 vendime. Për më tepër, komunat nuk kanë publikuar 3 akte, ndërsa niveli i publikimit të përgjithshëm është në shkallën 99.8%. Llogaritjet e bëra marrin për bazë të dhënat për 33 komuna, ngase niveli i publikimit në komunat tjera, si: Leposaviq, Shtërpcë, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut është 0%. Sa i përket publikimit të rregulloreve, shkalla e publikimit të rregulloreve në 30 komuna është 79%, kurse 8 komuna ose 21% e tyre nuk kanë publikuar asnjë rregullore.


Komunat kanë ofruar informacione të tjera për palët e interesuara përmes ueb-faqeve zyrtare të tyre. Janë gjithsej 104 dokumente financiare të publikuara, ku performancë më të mirë në këtë drejtim kanë treguar komunat: Pejë dhe Suharekë. Ndryshe nga to, komunat që nuk kanë publikuar asnjë dokument buxhetor janë: Kllokot, Mamushë, Partesh, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Qasja në dokumentet publike – Komunat kanë treguar trend pozitiv në mundësimin e qasjes në dokumente publike sipas kërkesave të parashtruara nga subjektet juridike, si dhe Ex- officio kur ligji këtë e kërkon. Numri i kërkesave të parashtruara është 1101, prej tyre me qasje të lejuar janë 1062 kërkesa (apo 96%), 28 janë të refuzuara (3%) dhe 11 të lejuara pjesërisht (1.86%). 5 komuna nuk kanë pasur asnjë kërkesë të parashtruar: Dragash, Leposaviq, Zveçan, Kllokot dhe Zubin Potok. Raporti në mes të numrit të kërkesave të parashtruara me kërkesat e refuzuara, është si vijon: komuna e Klinës nga 45 kërkesa të parashtruara

për qasje në dokumente publike 14 ka të refuzuar, komuna e Ferizajt nga 44 kërkesa të parashtruar 4 ka të refuzuar dhe 7 të lejuar pjesërisht, komuna e Prishtinës nga 88 kërkesa të parashtruara 6 ka të refuzuar, komuna e Malishevës nga 35 kërkesa të parashtruara, 1 e ka të refuzuar, komuna e Podujevës nga 34 kërkesa të parashtruara, 3 të refuzuara, komuna e Vitisë nga 56 kërkesa të parashtruara, ka 1 të lejuar pjesërisht, komuna e Shtërpcës nga 12 kërkesa të parashtruara, 1 ka të lejuar pjesërisht, komuna e Skenderajt nga 6 kërkesa të parashtruara, ka 1 kërkesë të lejuar pjesërisht dhe komuna e Glllogocit prej 36 kërkesave të parashtruara, 1 kërkesë është e pjesërisht lejuar.


Siguria në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB është organ këshillëdhënës ndërsektorial, përgjegjës për çështjet e sigurisë në nivel lokal. Funksionimi i këshillave për siguri në bashkësi rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Për shkak të normimit të standardeve të funksionimit të tyre, ka pasur ngritje të vetëdijes institucionale për rëndësinë e KKSBB-ve, duke bërë që angazhimi i komunave të fokusohet edhe në çështjet e përgjithshme të sigurisë, përfshirë këtu: vetëdijesimin e qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsej 186 takime të KKSBB-ve. Në vijim është paraqitur figura e takimeve të KKSBB-ve sipas komunave:



Diagrami 6: Numri i takimeve të KKSBB-ve sipas komunave, Janar-Dhjetor 2019.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se në mbajtjen e takimeve të KKSBB-ve më aktive kanë qenë komunat: Hani i Elezit, Klllokot, Glllogoc dhe Rahovec. Krahasuar me kriterin minimal të kërkuar sipas udhëzimit përkatës administrativ, 23 komuna kanë përmbushur obligimin prej 6 apo më shumë takimeve, derisa 11 komuna të tjera renditen nën standardin minimal të kërkuar, si dhe 4 komuna: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok akoma nuk i kanë të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.



Në krahasim me vitet paraprake, gjatë vitit 2019 shihet se ka pasur ngritje të aktiviteteve të KKSBB-ve. Sipas të dhënave, në vitin 2016 janë mbajtur 177 takime të KKSBB-së, në 2017 gjithsej 119 takime (për shkak të vitit zgjedhor), në 2018 janë mbajtur 184 takime, si dhe në vitin 2019 janë mbajtur gjithsej 186 takime.

MAPL, gjatë vitit 2019, në kuadër të zhvillimit të sistemeve të informacionit ka krijuar edhe një qasje të veçantë në ueb-faqet e komunave, që i mundëson publikut raportimin online të problemeve të sigurisë, parashtrimin e pyetjeve dhe kërkesave lidhur me sigurinë, si dhe marrjen e përgjigjeve nga autoritetet komunale. Ky sistem duhet të aplikohet nga zyrtarët përgjegjës të komunave, në mënyrë informatat të cilat raportohen nga qytetarët të mund të administrohen nga institucionet përgjegjëse në të mirë të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sigurisë në bashkësi.

Grafikoni 7: Krahasimi i numrit të takimeve të KKSBB-ve sipas viteve të fundit.


Krahas KKSBB-vë, në 23 komuna janë themeluar edhe Ekipet Vepruese për Siguri (EVS). Gjatë kësaj periudhë janë mbajtur 42 takime të EVS-ve. Këto forume duhet të themelohen në 15 komuna të tjera, si: Fushë Kosovë, Klllokot, Zveçan, Gjakovë, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Kaçanik, Skenderaj, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sa i përket, Këshillave Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve), ato janë funksionale në 24 komuna, ku gjatë periudhës në fjalë kanë mbajtur 178 takime ndërsa funksionalizimi ende nuk është bërë në 14 komunat: Zubin Potok, Ranillug, Gjakovë, Zveçan, Mitrovicë Jugore, Hani i Elezit, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Dragash, Junik, Kaçanik, Mamushë dhe Novobërdë.

Kuvendet e komunave dhe kryetarët e tyre, duhet të fokusohen më tepër rreth prioriteteve të sigurisë, e posaçërisht për funksionalizimin e KKSBB-së, si organ kryesor për përfaqësimin e nevojave të sigurisë së qytetarëve. Gjithashtu, komunat duhet shtuar numrin e takimeve të këtij Këshilli së paku deri në pragun minimal të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ.

Mbikëqyrja e komunave

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së komunave është kompetencë e autoriteteve qendrore varësisht nga fushat e lëndës në të cilën ushtrohet ky funksion. Parimisht, MAPL është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi

i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato”². Procesi i shqyrtimit administrativ të akteve komunale është rregulluar më detajisht me Rregulloren (QRK) NR-10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave. Gjatë vitit 2019, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 2038 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (148 rregullore dhe 1890 vendime). Në vijim, është paraqitur figura me të dhënat për procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale:



Diagrami 8: Procesi i shqyrtimit administrativ.


Nga diagrami i lartcekur shihet se kanë qenë të aprovuara gjithsej 2038 akte nga kuvendet e komunave, prej tyre, MAPL ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së 976 akteve apo 47.8%, ndërsa 1062 akte janë shqyrtuar nga ministritë e linjës (52.1%). Gjithsej janë konstatuar 157 shkelje, prej të cilave 56 janë konstatuar nga MAPL dhe 101 nga ministritë e linjës. Në këtë proces, komunat kanë arritur të harmonizojnë gjithsej 106 akte, derisa 51 akte mbeten të pa harmonizuara me ligj apo 2.5% nga totali i akteve të aprovuara. Lidhur me këtë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka iniciuar procedurat e kundërshtimit gjyqësor përmes Ministrisë së Drejtësisë për 29 akte të kuvendeve të komunave si vijon: Vushtrri (1), Gjakovë (4), Lipjan (3), Skenderaj (3), Deçan (3), Prishtinë (9), Malishevë (2), Graçanicë (1), Prizren (1), Gjilan (1) dhe Mitrovicë Jugore (1). Komunat të cilat nuk kanë harmonizuar aktet edhe pas dërgimit të kërkesës për rishqyrtim nga autoriteti mbikëqyrës janë: Prizren (2), Malishevë (1), Ferizaj (1), Gjilan (1), Dragash (1), Deçan (2), Shtime (1), Istog (1), Mitrovicë Jugore (1), Junik (1), Kamenicë (1), Vitisë (1), Kllokot (1), Graçanicë (1), Ranillug (1), Shtërpçë (1), Glllogoc (2), Gjakovë (1) dhe Fushë Kosovë (1).

² Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kreu X, Nenet 75 dhe 76.

AGJENDA EVROPIANE

Zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim është një ndër prioritetet më të rëndësishëm të Republikës së Kosovës e cila është nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian dhe ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016 ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, dokument i cili i obligon institucionet shtetërore t'i kryejnë të gjitha obligimet e kërkuara në këtë proces. Komunat si nivel i veçantë i institucioneve të administratës shtetërore kanë përgjegjësinë e tyre në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Në këtë drejtim Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në këtë fushë me nivelin lokal të qeverisjes, gjatë vitit 2019 ka ndërmarrë një sërë veprimesh për adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane, si:

- Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kritereve kryesore të integritimit: a) Kriteret Politike, b) Kriteret Ekonomike dhe c) Standardet Evropiane.
- Komunat kanë ofruar informatat duke u bazuar në planet individuale të hartuara nga MAPL, të cilat përfshijnë obligimet më kuadër të: Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, sfidave të qeverisjes lokale të identifikuar nga Raporti i Vendit dhe dokumentet e tjera relevante.
- Bazuar nga të dhënat e ofruara nga komunat, gjatë vitit 2019 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 71% të detyrimeve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 71% të kritereve; si dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 66% të detyrimeve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2019 është 69%, dhe është paraqitur si vijon:



Diagrami 9: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane

Kriteret politike

Stabiliteti i institucioneve në qeverisjen demokratike, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve jo shumicë, është një nga kapitujt kryesor të një vendi që duhet përmbushur në raport me agjendën e integritimit evropian. Përmbushja e kriterëve politike është obligim i cili duhet përmbushur nga Kosova si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE. Në këtë pjesë të raportit janë përfshirë të dhënat për aktivitetet e komunave në fushën e kriterëve politike, me fokus: fuqizimin e administratës publike lokale, bashkëpunimin me shoqërinë civile, luftën kundër terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe komuniteteve jo shumicë, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat pronësore, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si dhe fushat e tjera respektive.

Një nga fushat kryesore që bën pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Gjatë vitit 2019 janë ndërmarrë aktivitete të shumta për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën e pushtetit lokal, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, ofrimin e këtyre shërbimeve me kosto sa më të ulët dhe në kohë reale, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, promovimin e qeverisjes elektronike, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, komunat kanë hartuar Programin dhe Databazën e trajnimeve. Programi i trajnimeve është hartuar në 33 komuna, me përjashtim të 5 komunave: Klllokot, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë dhe Zubin Potok, të cilat nuk kanë përmbushur këtë obligim. Lidhur me zbatimin e programit për ngritje të kapaciteteve, të dhënat flasin për 30 komuna të cilat kanë organizuar trajnime të ndryshme. Sipas të cilave të dhëna, janë mbajtur mesatarisht 28 trajnime për komuna, gjatë vitit 2019, apo mesatarisht nga 30 zyrtarë të trajnuar për secilën komunë.

Gjatë kësaj periudhe, komunat kanë ndërmarrë veprime konkrete që komunitetet jo shumicë të përfshihen në administratën publike, përmes: zbatimit të ligjeve në fuqi lidhur me të drejtat për punësim të komuniteteve jo shumicë, inkurajimit të tyre për përfshirje me anë të fushatave vetëdijësuese, si dhe fuqizimit të rolit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Numri i të punësuarve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në institucionet publike lokale sipas të dhënave të 32 komunave është afër 10%. Krahas tyre 6 komuna: Gjakovë, Glllogoc, Mamushë, Junik, Kaçanik dhe Klllokot nuk kanë ofruar të dhëna.

Komunat kanë ofruar bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile. Një rrjet i gjerë i organizatave jo-qeveritare që veprojnë në vend përcjellin dhe angazhohen në projekte të cilat synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve. Nga të dhënat e prezantuara, shumica e komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Numri i projekteve të OJQ-ve të përkrahura në 32 komuna është 942 projekte, ndërsa 6 komuna: Zubin Potok, Klllokot, Partesh, Mitrovicë Veriore, Leposaviq dhe Shtërpçë nuk kanë financuar asnjë projekt të OJQ-ve në këtë periudhë.

Zbatimi i strategjisë nacionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe strategjisë kundër terrorizmit është zgjeruar edhe në nivelin lokal të administratës. Komunat kanë ndërmarrë veprime

konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shprijë në ekstremizëm të dhunshëm. Fushata të tilla janë organizuar në 23 komuna, përmes aktiviteteve si në vijim: fushata vetëdijesuese, aktivitete në terren, takime të rregullta me anëtarët e KKS-së, takime me përfaqësues të komuniteteve fetare, etj. Në anën tjetër, 15 komuna: Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prishtinë, Podujevë, Graçanicë, Junik, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpcë, Vushtrri, Mamushë dhe Novobërdë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim/aktivitet për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shprijë në ekstremizëm të dhunshëm.

Lidhur me deklarin e pasurisë, në 34 komuna është raportuar për 1449 zyrtarë komunal të cilët kanë deklaruar pasurinë, ndërsa nuk janë ofruar të dhënat nga 4 komunat: Ranillug, Mamushë, Partesh dhe Mitrovicë Veriore. Në 35 komuna nuk është raportuar për raste të deklarimit të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal, ndërsa në 3 komuna: Deçan, Skenderaj dhe Zveçan ka pasur 97 raste. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale (neni 38), para marrjes së vendimeve në kuvendin e komunës që kanë të bëjnë me cilëndo çështje ku mund të vie në shprehje interesi personal apo material, anëtarët e kuvendeve obligohen të deklarojnë konfliktin e interesit. Lidhur me këtë çështje, në 32 komuna nuk ka pasur deklarime të konflikteve të interesit nga anëtarët e kuvendit, ndërsa në 6 komuna të tjera: Zveçan, Mamushë, Lipjan, Deçan, Skenderaj dhe Kaçanik kanë qenë 75 raste të deklarimit të konfliktit të interesit.

Për të përmirësuar aspektet operacionale të punës në administratë, përgjegjësinë vendimmarrëse, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve, komunat kanë hartuar Planet Lokale të Integritetit. Këto plane janë hartuar në 20 komuna, ndërsa mbetet për t'u hartuar në 18 komuna: Gjakovë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Kamenicë, Deçan, Dragash, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpcë, Obiliq, Mamushë dhe Novobërdë. Përveç kësaj, në 13 komuna janë caktuar zyrtarët përgjegjës për raportim lidhur me zbatimin e Planeve Lokale të Integritetit, ndërsa në 25 komuna të tjera nuk janë caktuar: Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klllokot, Hani i Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Deçan, Dragash, Graçanicë, Junik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpcë, Obiliq, Mamushë dhe Novobërdë. Po ashtu, në 6 komuna janë publikuar raportet në ueb faqet zyrtare të komunave mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet.

Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Janë 22 komuna të cilat kanë hartuar Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Fëmijëve, derisa 16 komuna të tjera ende nuk i kanë miratuar këto rregullore: Klllokot, Partesh, Zveçan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Shtërpcë, Dragash, Graçanicë, Junik dhe Klinë. Gjithashtu në 7 komuna është hartuar Strategjia Kundër Dhunës në Familje, kurse në 31 komuna nuk është hartuar: Shtime, Ferizaj, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Hani i Elezit, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Viti, Deçan, Glllogoc, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpcë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë dhe Suharekë. Autoritetet komunale kanë ndërmarrë masa edhe për parandalimin e dhunës në familje. Në 21 komuna është raportuar për 617 raste të dhunës në baza gjinore, për çfarë në 13 komuna janë themeluar Këshillat Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe kanë zhvilluar 39 takime.

Gjatë periudhës raportuese, janë paraqitur 15 raste të strehimit dhe kompensimit të viktimave të trafikimit në 7 komuna: Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Viti, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Glllogoc, ndërsa në 31 komuna nuk është raportuar për raste të strehimit.

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve kanë një shtrirje të veçantë në nivel lokal. Në 27 komuna është ndarë buxhet i veçantë për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, ku shuma e ndarë është 11,028,780.00 €. Gjithashtu, ekziston një kuadër normativ i avancuar për të promovuar diversitetin gjuhësor në komuna. Aktualisht Rregullorja për përdorimin e gjuhëve nuk është hartuar vetëm në komunën e Ranillugut dhe Zveçanit. Staf i profesional për përkthim është rekrutuar në 26 komuna, 1 komunë (Podujevë) pjesërisht derisa 11 të tjera nuk ka staf të veçantë për përkthim, si komunat: Gjilan, Zubin Potok, Hani i Elezit, Kamenicë, Glllogoc, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Laposaviq, Obiliq, Mamushë dhe Novobërdë.

Implementimi efektiv i legjislacionit për trashëgiminë kulturore ka qenë pjesë e angazhimeve të vazhdueshme të organeve komunale. Sipas të dhënave, Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e kanë hartuar 3 komuna, ndërsa nuk është hartuar në 35 komuna: Viti, Istog, Klllokot, Hani i Elezit, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Shtime, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Skenderaj, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Glllogoc, Graçanicë, Junik, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Laposaviq, Shtërpçë dhe Dragash. Gjithashtu, 25 komuna kanë ndërmarrë veprime konkrete për definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjzimitin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 5 raste të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura të komunave: Prizren, Klinë dhe Skenderaj, për të cilat janë ndërmarrë masat përkatëse procedurale. Po ashtu, 10 komuna kanë vendosur pajisjet për monitorimin e sigurisë të tërësive të trashëgimisë kulturore të kishës ortodokse.


Kanë vazhduar të jenë funksional edhe dy këshillat e themeluara në Rahovec dhe Prizren, përkatësisht: Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit. Komuna e Prizrenit ka alokuar fondin në vlerë prej 57,020,00 euro € për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore për Qendrën Historike të Prizrenit, kurse Komuna e Rahovecit ka ndarë 22,743.00€ për fshatin Hoçë e madhe. Në Komunën e Prizrenit janë caktuar personat përgjegjës për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit, shtuar rolin e Task-Forcës së themeluar për Qendrën Historike të Qytetit të Prizrenit, e cila ka bërë identifikimin e objekteve të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike.

Gjatë kësaj periudhe, 24 komuna kanë ndërmarrë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si: zhvillimi i takimeve të ndryshme sensibilzuese, shpërndarja e broshurave me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve për mbrojtjen dhe trashëgiminë kulturore, organizimi i ekspozitave nga fusha e Trashëgimisë Kulturore, organizime të punëtorive etj, për të cilat janë 14 komuna: Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Klllokot, Hani i Elezit, Zveçan, Dragash, Glllogoc, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë dhe Novobërdë që nuk kanë zhvilluar aktivitete.

Kriteret ekonomike

Zhvillimi ekonomik mbetet një nga prioritetet kryesore në nivel vendi. Politikat ekonomike përbëjnë substancën programore pothuajse të të gjithë mekanizmave të administratës shtetërore, përfshirë komunat të cilat kanë një rol të padiskutueshëm në këtë drejtim. Në vitin 2019 ka filluar implementimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, ndërkohë janë duke u bërë ndryshimet në ligjin për financat e pushtetit lokal. Këto ndryshime strukturore përfshijnë opsionet përkatëse që ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të komunave, krijimin e kushteve për zhvillim të bizneseve, rritjen e investimeve kapitale, balancimit të investimeve sipas vlerësimeve reale, shfrytëzimit efikas të pronës komunale për investime nga jashtë, si dhe në shumë sektorë të tjerë të ndikimit.

Sa u përket aktiviteteve konkrete të parapara në planet e komunave të kësaj fushë, gjatë vitit 2019 në 28 komuna janë krijuar kushte të nevojshme për funksionimin e qendrave *one-stop-shop*, të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese, përfshirë regjistrimin e tyre. Edhe më tutje mbetet që në 10 komuna të tjera të kompletohet kjo strukturë e këtyre qendrave duke shtrirë rrjetin e tyre edhe në komunat: Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Kllokot, Partesh, Zveçan, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Mamushë. Sipas të dhënave për 32 komuna, në vitin 2019 janë hapur gjithsej 9149 biznese të reja, gjersa janë mbyllur 1216 biznese në komuna.



Diagrami 10: Numri i bizneseve të hapura dhe të mbyllura gjatë vitit 2019.

Në shumicën e komunave problemet që vështirësojnë kushtet e të bërit biznes konsiderohen: tregu i pasigurt për plasimin e produkteve të tyre, kreditë jo të favorshme për biznese, mungesa e investimeve strategjike dhe investimeve direkte nga jashtë, mungesa e subvencionimit të bizneseve për vendet e reja të punës, konkurrenca jolojale, ekonomia joformale, kosto e lartë e operimit, mungesa e fuqisë punëtore të profesionalizuar. Në këtë drejtim 13 komuna kanë hartuar Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal. Vetëm nga kategoria e subvencioneve të bizneseve, sipas të dhënave për 16 komuna, kanë përfituar një numër i konsiderueshëm i bizneseve në vlerën totale prej 623,428.30 euro. Për të ndikuar në luftimin e ekonomisë

joformale, në komuna janë të angazhuar 58 inspektorë të tregut. Komunitat janë koncentruar edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, ngase sfida mbetet sidomos shpenzimi i mjeteve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Në funksion të menaxhimit më cilësor, 31 komuna kanë miratuar Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditorit me përjashtim të komunave: Ranillug, Prishtinë, Partesh, Kllokot, Graçanicë, Deçan dhe Mitrovicë e Veriut. Mbështetja e bizneseve është bërë edhe përmes ofrimit të pronës komunale në shfrytëzim për realizimin e projekteve investive. Sipas të dhënave, 32 komuna kanë krijuar regjistrimin e pronës së paluajtshme.

Standardet Evropiane

Komponentë kryesore e zhvillimit ekonomik lokal mbetet sektori i bujqësisë, për çfarë është dhënë mbështetje e konsiderueshme financiare nga komunitat. Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është hartuar në 14 komuna, gjithashtu 33 komuna kanë mbështetur 8057 fermerë, derisa kjo politikë duhet të praktikohet edhe nga komunitat: Ranillug, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore.

Në 33 komuna janë funksionale qendrat për informimin e bujqve, ku gjatë periudhës raportuese janë trajnuar rreth 2545 bujq. Qendrat trajnuese të bujqve duhet të themelohen edhe në komunitat: Zubin Potok, Hani i Elezit, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Leposaviq. Gjatë periudhës raportuese në komuna janë paraqitur rreth 2709 kërkesa për mbrojtjen e tokës bujqësore. Sipas të dhënave, në 16 komuna janë të sistemuar inspektorë të bujqësisë. Deri në këtë periudhë vetëm 3 komuna e kanë hartuar Planin për menaxhimin e tokave rurale.

Një numër i aktiviteteve janë zhvilluar edhe në fushën e energjisë. Plani për energji eficiente është hartuar në 32 komuna. Duhet marrë veprime që këto plane të hartohen edhe në 6 komuna që nuk i kanë në dispozicion: Prishtinë, Kllokot, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Ranillug dhe Malishevë. Për fushën e efijencës janë mbajtur 78 trajnime, derisa ngritja e kapaciteteve duhet të jetë objektive edhe për 9 komuna të tjera: Gjakovë, Ranillug, Zubin Potok, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Shtërpçë, Kllokot, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore.

Komunitat kanë shënuar progres në krijimin e mekanizmave lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit. Konform obligimeve ligjore, 27 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtje nga diskriminimi. Kjo çështje mbetet e pazbatuar në 11 komuna: Zubin Potok, Podujevë, Kamenicë, Deçan, Glllogoc, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Mamushë dhe Obiliq ende nuk kanë emëruar zyrtarin përkatës.

Për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve për qytetarë, komunitat janë kujdesur të krijojnë mekanizma të brendshëm për ofrimin e ndihmës juridike falas të cilat zyre në bazë të legjislacionit në fuqi themelohen përmes zyrave rajonale në 7 regjione. Sipas të dhënave zyrtare për ndihmë juridike falas janë funksionale vetëm në 4 regjione: Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan. Numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë periudhës raportuese është 1679 persona.

Sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, në 37 komuna është caktuar zyrtari përkatës komunal për mbrojtjen e të dhënave personale ndërsa në 1 komunë Zubin Potok ende nuk është caktuar. Gjithashtu, baza e të dhënave personale është funksionalizuar në 32 komuna, kurse në 6 komuna: Istog, Klllokot, Zveçan, Mamushë, Mitrovicë e Veriut dhe Leposaviq nuk është funksionalizuar ende. Krahas kësaj, siguria fizike e dokumentacionit (*rojat fizike, vendosja e kamerave, grilat dhe kasafortat, etj.*) është përmirësuar në 36 komuna, ndërsa në 2 komuna: Mitrovicë e Veriut dhe Ranillug nuk është në nivelin e dëshiruar.

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve janë shtrirë në të gjitha komunat, me përjashtim të Komunës së Zubin Potokut ku nuk është funksionale ende Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim. Komunat janë ndër aktorët më të rëndësishëm për krijimin e kushteve relevante për riintegrimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Nga raportimi i 33 komunave shohim se 16 komuna kanë miratuar Planin Komunal për Ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar ndërsa në 17 komuna: Malishevë, Gjilan, Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Mitrovicë, Viti, Klllokot, Zveçan, Glllogoc, Junik, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Suharekë dhe Novobërdë ende nuk është hartuar. Gjatë periudhës raportuese në komuna numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar është 3823, derisa në 13 komuna janë paraqitur 276 kërkesa për pajisje me dokumentacionin e gjendjes civile. Verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar është bërë përmes Zyrave Komonale të Gjendjes Civile, Zyrave për Komunitete dhe Kthim, si dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim. Ka pasur një numër të madh të aplikimeve për përfitim nga fondi për riintegrim, rreth 343 sosh. Si rrjedhojë, në 11 komuna: Gjakovë, Kamenicë, Klinë, Fushë Kosovë, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Prizren, Skenderaj, Shtërpçë dhe Zubin Potok janë rindërtuar 106 shtëpi për personat e kthyer. Veç kësaj, janë paraqitur edhe 301 aplikime për zhvillim të bizneseve në 18 komuna nga personat e riatdhesuar.


Janë ndërmarrë veprime të matshme për zbatimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian është miratuar në 15 komuna. Ky plan mbetet të hartohet në të gjitha komunat në të cilat jetojnë pjesëtarë nga ky komunitet. Janë 6 komuna ku nuk jeton asnjë nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas: Ranillug, Glllogoc, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit dhe Partesh. Sipas të dhënave për 15 komuna, numri i personave të regjistruar nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë 1199. Në rritjen e numrit të aplikimeve për regjistrim kanë ndikuar fushatat sensibilizuese të organizuara nga komunat. Kësisoj janë organizuar 103 fushata vetëdijësuese në 13 komuna.

Lufta kundër narkotikëve ka marrë vëmendjen e komunave, me qëllim të arritjes së rezultateve për uljen e përdoruesve të drogave dhe parandalimin e ndikimit të tyre sidomos në shkolla. Komunat kanë ndërmarrë aktivitete të shumta përmes: ligjëratave të mbajtura në shkolla nga pedagogët dhe psikologët e shkollave, bashkëpunimit me policinë si dhe forumeve të sigurisë në bashkësi.

Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Një pjesë e madhe tyre kanë planifikuar buxhet për bursat e nxënësve dhe studentëve. Numri i përfituesve të këtyre bursave në 26 komuna është 2777 nxënës/studentë. Mbështetja e të rinjve përmes programeve të financimit duhet të jetë prioritet edhe në komunat: Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Shtërpçë, Zveçan,

Mamushë, Kllokot, Graçanicë, Partesh dhe Mitrovicë Veriore. Të dhënat e 26 komunave tregojnë për gjithsej 570 fëmijë me nevoja të veçanta janë të përfshirë në institucionet parashkollore. Çështja e braktisjes së shkollimit nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë e evidente ndër vite, sipas të dhënave të 13 komunave, numri i braktisjes së shkollimit nga ky komunitet ka qenë 225 nxënës, për të cilat vetëm 5 komuna kanë hartuar Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë. Arsimi profesional është një fushë e veçantë dhe me perspektivë për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Në 32 komuna, janë funksionale 90 shkolla profesionale dhe atë në drejtime të ndryshme përfshirë drejtimin: mekanik, elektronik, ndërtimtari, ekonomi, teknikë etj. Këto shkolla mungojnë në komunat: Zubin Potok, Kllokot, Hani i Elezit, Mamushë, Mitrovicë e Veriut dhe Junik.

Komunat përballen me vështirësi të shumta në fushën e mjedisit, problemin e mbeturinave, ndotjen e ajrit dhe deponitë e parregullta. Përkundër kompetencave ligjore të komunave në fushën e mbrojtjes së ajrit, Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk e ka hartuar asnjë komunë. Në anën tjetër janë 31 komuna të cilat kanë miratuar planin lokal për menaxhimin e mbeturinave, mirëpo mbetet për tu hartuar në komunat: Mamushë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Malishevë, Ranillug, dhe Zubin Potok. Komunat kanë ndërmarrë edhe fushata vetëdijësuese lidhur me mbrojtjen e ambientit. Sipas të dhënave në 23 komuna janë organizuar 152 fushata vetëdijësuese, ndërsa në 15 komuna: Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Pejë, Podujevë, Shtërpçë, Zveçan, Mamushë, Junik, Kllokot dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë mbajtur asnjë fushatë. Përkundër kësaj, numri i deponive ilegale është tejet i madh, në 28 komuna janë evidentuar 1624 deponi ilegale. Sa i përket numrit të inspektimeve për zbatimin e Ligjit kundër duhanit në 23 komuna janë realizuar 1952 inspektime. Ndërsa, në 8 komuna gjatë periudhës raportuese janë shqiptuar 128 gjoba dhe në 2 komuna të tjera: Skenderaj dhe Fushë Kosovë janë shqiptuar 187 vërejtje.



Diagrami 11: Numri i deponive ilegale në komuna.

Është parë një interesim i komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhë janë ndërmarrë 27 iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal nga 29 komuna. Këto iniciativa janë ndërmarrë me qëllim të bashkëpunimit në fushën e parandalimit, reagimit dhe ripërtëritjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Sa i përket Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar, në kuadër të kësaj fushe janë realizuar 8 marrëveshje në mes të komunave: Lipjan - Civita dhe Frascineto (Itali), Fushë Kosovës - Civita dhe Frascineto (Itali), Rahovec - Civita dhe Frascineto (Itali), Gjilan - Iowa Sioux City, Pejë - (Iowa) Johnston, Gjakovë - (Iowa) Fort Dodge, Vushtrri - (Iowa) City of NorWalk dhe Prishtinë – (Iowa) City of Des Moines. Marrëveshjet kryesisht kanë subjekt të bashkëpunimit: Arsimin, Kulturën, Sportin, Turizmin dhe Zhvillimin ekonomik. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe iniciativat nga komunat: Rahovec – Vlorë (Shqipëri), Rahovec, Istog, Graçanicë, Kamenicë dhe qyteteve të IOWA-së, Pejë – Durrës (Shqipëri) – Ulqin (Mali i Zi) – Bujanoc (Serbi) – Tetovë – (Maqedoni) – Zarë (Kroaci), Hani i Elezit – Celano (Itali), Viti – Kirchhain (Gjermani), Podujevë – Velbert (Gjermani) në fushën në çështjeve të marrëdhënieve ekonomike, teknologjike, kulturore, rini, sport, trashëgimi kulturore dhe shoqërore, si dhe nxitje të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020.

FINANCAT LOKALE

Komunat kanë burime të shumta të financimit me të cilat disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në përputhje me ligjet e zbatueshme. Burimet financiare komunale kërkohet të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Financat lokale janë pjesë përbërëse e KASH-it, si dokument strategjik 3-vjeçar që hartohet mbi bazën e prioriteteve dhe objektivave të Qeverisë. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave, si dhe pjesëmarrja bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Burimet financiare të një komune përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga Republika e Serbisë dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës. Komunat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi gjatë disponimit me këto burime financiare. Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblihen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkëpagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhëna të rëndësishme për planifikimin e të hyrave vetanake të komunave për vitin 2019, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet e buxheteve komunale.

Planifikimi i të hyrave vetanake

Për vitin 2019, planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë në vlerë prej 87,000,000.00 €. Krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2018 në vlerë prej 81,498,030.07 €, planifikimi për vitin 2019 ka qenë më i lartë për 5,501,969.93 € ose shprehur në përqindje 6.75%.

Realizimi i të hyrave vetanake

Komunat i mbledhin të hyrat vetanake në dy forma: a) si të hyra të mbledhura drejtpërdrejt nga komuna (si aktivitet i komunës) dhe b) si të hyra të arkëtuara nga niveli qendror (të hyrat indirekte), të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake. Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2019 ka arritur vlerën prej 89,259,105.16 €, prej të cilave 77,813,475.88 € kanë qenë të hyra direkte dhe 11,445,629.28 € të hyra indirekte. Nëse kjo vlerë krahasohet me vlerën totale të planifikuar, në shumën prej 87,000,000.00 €, atëherë shohim që realizimi ka arritur nivelin prej 103%. Inkasimi i të hyrave vetanake direkte për vitin 2019 në vlerë prej 77,813,475.88 € krahasuar me inkasimin e të hyrave të llojit të njëjtë për vitin 2018 në vlerë prej 70,996,498.41 €, është më i lartë për 6,816,977.47€, apo 9.60%.


Sipas të dhënave zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, komunat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019 kanë grumbulluar shumën prej 77,813,475.88 € të hyra vetanake direkte ose 89% nga niveli i planifikuar vjetor prej 87,000,000.00 €.

Në bazë të përqindjes së inkasimit të të hyrave vetanake, komunat kanë nivelin e realizimit si vijon:

- Të hyra vetanake me përqindje më të madhe apo mbi 100% kanë realizuar këto komuna: Fushë Kosovë, Klinë, Skenderaj, Junik, Hani i Elezit dhe Kllokot;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 80-100% kanë realizuar këto komuna: Glogoc, Lipjan, Obiliq, Prishtinë, Shtime, Graçanicë, Prizren, Rahovec, Malishevë, Mamushë, Deçan, Istog, Gjakovë, Junik, Vushtrri, Gjilan, Shtërpçë, Ferizaj, Partesh, Pejë, Mitrovicë dhe Viti;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 60-70% kanë realizuar këto komuna: Podujevë, Dragash, Kaçanik, Kamenicë dhe Ranillug;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 0-50% kanë realizuar këto komuna: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Novobërdë.

Kategoritë që kanë ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë:

- *Tatimi në pronë*, i cili gjatë vitit 2019 është inkasuar në shumën prej 27,312,960.00 €, për 3,040,897.00 € më i lartë se në vitin 2018, që ishte 24,272,063.00 €;
- *Të hyrat komunale për leje ndërtimi*, ku gjatë vitit 2019 është inkasuar shuma prej 17,950,283.00 € që është inkasim më i lartë prej 2,401,335.00€ se gjatë periudhës së vitit 2018 që ishte 15,548,948.00 €.
- *Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike*, ku në vitin 2019 inkasimi është realizuar në vlerën prej 5,779,699.00 € krahasuar me vitin 2018, ku inkasimi ishte në vlerën prej 5,606,447.00 €, vërehet që kemi një ngritje të lehtë të nivelit të inkasimit të të hyrave nga ndërrimi i destinimit të tokës.



Diagrami 12: Krahasimi i të hyrave që kanë ndikim në rritjen e të hyrave vetanake gjatë vitit 2018 me vitin 2019.

Buxheti Komunal për vitin 2019

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunitet e Republikës së Kosovës për vitin 2019 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 503,970,478,79 ose 88 % e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 573,581,115.13 €. Bazuar në gjendjen e fundit të raporteve vjetore në SIMFK, për vitin 2019 komunitet e Kosovës kanë pasur në dispozicion buxhetin në shumë prej 573,581,115.13€, apo për 50,389,200.79€, më shumë krahasuar me vitin 2018, i cili ka qenë në shumë prej 523,191,914.34€.

Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike është shpenzuar si vijon:

- Kategoria Rroga dhe Mëditje:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë 272,948,986.87€ ndërsa i shpenzuar 263,431,795.36€ ose 97%. Krahasuar me buxhetin në të gjitha komunitet është shpenzuar nga 69-100 %, me përjashtim të komunave veriore Zubin Potok (69%) dhe Mitrovicë e Veriut (71%), kurse komunitet të cilat e kanë shpenzuar buxhetin 100% në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë: Novobërdë, Graçanicë, Kllokot dhe Ranillug.
- Kategoria Mallra dhe Shërbime:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë 69,574,108.57€ ndërsa i shpenzuar 64,168,158.58 € ose 92%. Krahasuar me buxhetin e planifikuar është shpenzuar në nivelin nga 61- 100%, ku përqindjen më të ulët të realizimit të shpenzimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve e ka komuna e Ranillugut me 61%, Kamenica me 77% dhe Vushtrria me 78%. Kurse komunitet të cilat kanë shpenzuar 100% në krahasim me buxhetin në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë komunitet: Graçanicë, Mamushë, Pejë, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Hani i Elezit dhe Kllokot.
- Kategoria Shpenzime komunale:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë 11,590,051.68€ ndërsa i shpenzuar 10,230,938.14 € ose 88%. Krahasuar me buxhetin është shpenzuar në nivelin nga 7 - 100%. Komunitet që kanë përqindjen më të ulët të realizimit të shpenzimeve në krahasim me buxhetin janë komuna e Zubin Potokut (7%), Zveçan me (9%) dhe Mitrovica e Veriut (44%). Kurse komunitet që kanë arritur përqindjen më të lartë të realizimit të buxhetit prej 100% janë komunitet: Malishevë, Mamushë, Deçan, Istog, Leposaviq, Novobërdë, Ferizaj, Viti, Hani i Elezit dhe Kllokot.
- Kategoria Subvencione dhe Transfere:** në këtë kategori gjatë kësaj periudhe të planifikuar kanë qenë 23,869,542.85€, ndërsa të shpenzuara kanë qenë 21,968,208.72€ ose 92 %. Të dhënat flasin se, krahasuar me buxhetin është shpenzuar në nivelin 90 - 100% në 29 komuna, në 2 komuna është shpenzuar në nivelin 80 – 89%, në 4 komuna është shpenzuar në nivelin 70-79%, ndërsa në 3 komuna është shpenzuar në nivelin 10-63%.

- **Kategoria Shpenzime Kapitale (pasuritë jo-financiare), sipas të dhënave në këtë kategori buxheti i planifikuar ka qenë 195,598,425.16€, ndërsa është shpenzuar 144,171,377.99 € ose 74%.** Krahasuar me buxhetin e planifikuar në 14 komuna është shpenzuar në nivelin 90- 99%, në 13 komuna është shpenzuar 80 – 89%, në 8 komuna është shpenzuar në nivelin 62 – 77% dhe në 2 komuna është shpenzuar 41-54%.

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se kategoria e pagave dhe mëditjeve është shpenzuar më së shumti deri 97%, kategoritë ekonomike Mallra dhe Shërbime dhe Subvencione dhe Transfere arrijnë deri në 92%, Shpenzime Komunale janë shpenzuar 88%, dhe më së paku është shpenzuar kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale me 74% krahasuar me buxhetin në dispozicion. Komunitat me përqindjen më të ulët të realizimit të buxhetit janë komuna e Prishtinës me 71 %, komuna e Zveçanit me 76% dhe komuna e Zubin Potoku me 77%. Kurse komuna me përqindjen më të lartë të realizimit të buxhetit është komuna e Klllokotit me 100% pastaj Vitia me 99%, si dhe Hani i Elezit me 98 %.

Opinionit i auditorit për komunat e Republikës së Kosovës

Opinionet e auditorit për komuna janë të ndryshme sipas viteve. Lloji i opinionit i cili më së shumti është dhënë në vitet 2017-2018 është opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, i cili është dhënë në 25 komuna në vitin 2017 dhe në 32 komuna në vitin 2018. Më pas vjen opinionit i kualifikuar – me theksim të çështjes, i cili është dhënë në 9 komuna për vitin 2017, ndërsa për vitin 2018 këtë lloj opinionit e kanë pranuar vetëm 3 komuna. Krahas kësaj, opinionit të kualifikuar në vitin 2017 dhe 2018 nuk kanë pranuar asnjë komunë. Po ashtu, opinionit të kundërt në vitin 2017 dhe në 2018 nuk ka marrë asnjë komunë, opinionit të pamodifikuar në vitin 2017 kanë marrë 4 komuna, kurse në vitin 2018 e kanë marrë 3 komuna. Opinionit i cili ju mundëson komunave për të filluar me procedura të huas komunale duhet të kenë dy vite radhazi (dy vitet e fundit) opinionit i pamodifikuar. Dy vite radhazi opinionit e pamodifikuar e ka vetëm komuna e Vitisë dhe Ranillugut. Në vijim mund të shihni pasqyrën me të dhëna lidhur me këto opinionet të auditorit sipas komunave dhe sipas viteve.

Opinionit i auditorit	Vitet	Komunat
Opinionit i pamodifikuar	2017	Viti, Pejë, Lipjan dhe Ranillug (4 komuna)
	2018	Viti, Shtime dhe Ranillug (3)

Opinion i pamodifikuar me Theksim të çështjes	2017	Prishtinë, Prizren, Mitrovicë Jugore, Gjakovë, Gjilan, Graçanicë, Shtërpçë, Shtime, Skenderaj, Deçan, Fushë Kosovë, Glllogoc, Hani i Elezit, Junik, Istog, Kaçanik, Kamenicë, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore (25 komuna)
	2018	Skenderaj, Mamushë, Malishevë, Klinë, Kamenicë, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit, Dragash, Deçan, Rahovec, Glllogoc, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtrri, Suharekë, Prizren, Podujevë, Pejë, Partesh, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Leposaviq, Klllokot, Istog, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Prishtinë (32 komuna)
Opinion i kualifikuar me Theksim të çështjes	2017	Dragash, Klinë, Klllokot, Malishevë, Mamushë, Rahovec, Ferizaj, Suharekë dhe Leposaviq (9 komuna)
	2018	Shtërpçë, Novobërdë dhe Ferizaj (3 komuna)
Opinion i kualifikuar	2017	
	2018	
Opinion i kundërt	2017	
	2018	

Tabela 1: Pasqyron opinionin e Auditorit për komunat e Republikës së Kosovës 2017 – 2018.

Rekomandimet

- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore;
- Komiteti për politikë dhe financa duhet të jetë më aktiv në komunën e Prizrenit;
- Të rritet intensiteti i takimeve të komitetit për komunitete në komunën e Kaçanikut;
- Komunat: Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Novobërdë, Mamushë dhe Ranillug të jenë më aktive në miratimin e akteve të kuvendit;
- Të arrihet kriteri minimal i dy raportimeve para kuvendit nga kryetarët e komunave: Novobërdë, Skenderaj, Klllokot, Partesh, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Prishtinë;
- Të mbahen së paku dy takime publike në vit sipas nenit 68.1 të LVL-së nga komunat: Podujevë, Kamenicë, Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Fushë Kosovë;
- Të funksionalizohen ueb-faqet nga komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore;
- Të publikohen në ueb-faqe procesverbalet e mbledhjeve të kuvendeve në komunat: Leposaviq, Obiliq, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Ranillug, Junik dhe Partesh;
- Të publikohen në ueb-faqe dokumentet buxhetore nga komunat: Klllokot, Mamushë, Partesh, Ranillug, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan;

- Të themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunat: Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore;
- Të zbatohet standardi minimal i Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi prej gjashtë apo më shumë takimeve nga komunat: Partesh, Kamenicë, Graçanicë, Novobërdë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Junik, Fushë Kosovë dhe Mamushë;
- Të themelohen Ekipet Vepruese për Siguri (EVS) në komunat: Fushë Kosovë, Klllokot, Zveçan, Gjakovë, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Kaçanik, Skenderaj, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Shtërpçë;
- Të themelohen Këshillat Lokale për Siguri Publike në komunat: Zubin Potok, Ranillug, Gjakovë, Zveçan, Mitrovicë Jugore, Hani i Elezit, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Dragash, Junik, Kaçanik, Mamushë dhe Novobërdë;
- Komunat: Prizren, Malishevë, Ferizaj, Gjilan, Dragash, Deçan, Shtime, Istog, Mitrovicë Jugore, Junik, Kamenicë, Viti, Klllokot, Graçanicë, Ranillug, Shtërpçë, Glllogoc, Gjakovë dhe Fushë Kosovë t'i harmonizojnë aktet e tyre konform kërkesave për rishqyrtim të dërguara nga autoriteti mbikëqyrës;
- Të hartohet programi i trajnimeve në komunat: Klllokot, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë dhe Zubin Potok;
- Komunat: Gjakovë, Ranillug, Zubin Potok, Kamenicë, Pejë, Vushtrri, Klllokot dhe Mitrovicë Veriore të zbatojnë programin për ngritje të kapaciteteve;
- Të ofrohet mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve nga komunat: Zubin Potok, Klllokot, Partesh, Mitrovicë Veriore, Leposaviq dhe Shtërpçë;
- Të ofrohen të dhëna për deklaram të pasurisë nga komunat: Ranillug, Mamushë, Partesh dhe Mitrovicë Veriore;
- Të hartohet Plani Lokal i Integritetit në komunat: Gjakovë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Kamenicë, Deçan, Dragash, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Obiliq, Mamushë dhe Novobërdë;
- Të caktohen zyrtarët përgjegjës për raportim lidhur me zbatimin e Planeve Lokale të Integritetit në komunat: Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klllokot, Hani i Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore, Kamenicë, Deçan, Dragash, Graçanicë, Junik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Obiliq, Mamushë dhe Novobërdë;
- Të hartohet rregullorja komunale për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve në komunat: Klllokot, Partesh, Zveçan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Shtërpçë, Dragash, Graçanicë, Junik dhe Klinë;
- Të ofrohen informacione për numrin e grave të punësuar në pozitat menaxheriale në komunat: Dragash, Rahovec dhe Mitrovicë e Veriut;
- Të zhvillohen fushata senzibilizuese, tryeza, seminare për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e të drejtave pronësore të grave në komunat: Klllokot, Junik, Zveçan dhe Mamushë;
- Të hartohet rregullorja për përdorim të gjuhëve në komunat: Ranillug dhe Zveçan;
- Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në komunat: Viti, Istog, Klllokot, Hani i Elezit, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Shtime, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Skenderaj, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Glllogoc, Graçanicë, Junik, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë dhe Dragash;
- Të kompletohet struktura e qendrave One-Stop-Shop duke shtrirë rrjetin e tyre edhe në komunat: Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Klllokot, Partesh, Zveçan, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Mamushë;

- Të miratohet Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditorit në komunat: Ranillug, Prishtinë, Partesh, Kllokot, Graçanicë, Deçan dhe Mitrovicë e Veriut;
- Të formohen qendrat trajnuese të bujqve në komunat: Zubin Potok, Hani i Elezit, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Leposaviq;
- Të hartohet Plani për energji efiçiente në komunat: Prishtinë, Kllokot, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Ranillug dhe Malishevë;
- Të caktohet zyrtari për mbrojtje nga diskriminimi në komunat: Zubin Potok, Podujevë, Kamenicë, Deçan, Glllogoc, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Mamushë dhe Obiliq;
- Të funksionalizohen zyrat për ndihmë juridike falas në regjionin: Prishtinë, Pejë dhe Prizren;
- Të caktohet zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personal e në komunën Zubin Potok;
- Të hartohet Plani Komunal për Ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunat: Malishevë, Gjilan, Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Mitrovicë Jugore, Viti, Kllokot, Zveçan, Glllogoc, Junik, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Suharekë dhe Novobërdë
- Komunat: Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Shërpcë, Zveçan, Mamushë, Kllokot, Graçanicë, Partesh dhe Mitrovicë e Veriut ta kenë prioritet mbështetjen e të rinjve përmes programeve të financimit;
- Të hartohet Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave në komunat: Mamushë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Shtërpcë, Malishevë, Ranillug dhe Zubin Potok;
- Të ndërmarrin fushata vetdijësuese lidhur me mbrojtjen e ambientit komunat: Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Pejë, Podujevë, Shtërpcë, Zveçan, Mamushë, Junik, Kllokot dhe Mitrovicë Veriore.

Botues

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

<http://mapl.rks-gov.net/>

Adresa Ish ndërtesa e Rilindjes Katet: 10, 11, 12 dhe 13 Prishtinë, Republika e Kosovës +381 (0) 200 35 630 (centrale)

